

VENDIM
Nr. 73, datë 17.10.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 17.10.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve kërkesën nr. 10 (Sh) 2024 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “ANK” SH.P.K., SHOQËRIA “BARDH KONSTRUKSION” SH.P.K., përfaqësuar nga avokate Lindita Sinanaj, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësuar me autorizim nga Etleva Malile.

Shoqëria “Sigal Uniq Group Austria” sh.a., në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1702, datë 13.9.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 00-2023-4463, datë 2.11.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, pika 1, 41, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkueseve, të cilat kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (*autoriteti kontraktor*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë “Sigal Uniq Group Austria” sh.p.k. (*shoqëria e sigurimeve*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN :

I

Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria “ANK” sh.p.k. është shoqëri tregtare e cila ushtron aktivitetin e saj kryesisht në fushën e ndërtimit të infrastrukturës rrugore, rikonstruksionit të shkollave dhe ujësjellës-kanalizimeve, kurse shoqëria “Bardh Konstruktion” sh.p.k. është shoqëri koncesionare ose e quajtur sipas ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar edhe subjekt për qëllime të veçanta (SPV) (*bashkërisht kërkuueset*).

2. Ndërmjet kërkueseve dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 27.3.2019 është nënshkruar kontrata koncesionare e partneritetit publik privat (PPP) nr. 1801 rep., nr. 469 kol., “Për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot-Balldre”. Kjo kontratë është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 52, datë 18.7.2019, “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, dhe shoqërisë “ANK” sh.p.k., si koncesionari dhe shoqërisë “Bardh Konstruktion” sh.p.k., si shoqëria koncesionare, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor

Milot-Balldre”. Ndër të tjera, neni 54 i kontratës së nënshkruar prej palëve përcakton mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis tyre.

3. Kërkueset, në zbatim të nenit 8 të kontratës, kanë paguar primin për lëshimin nga shoqëria e sigurimeve të sigurimit të kontratës nr. 16/TRSG21, e cila është nxjerrë në datën 8.11.2021.

4. Me shkresën nr. 1074/4 prot., datë 13.9.2022, me lëndë: “Mbi transferimin e vlerës së sigurimit të kontratës”, autoriteti kontraktor ka kërkuar transferimin e vlerës së sigurimit të kontratës nga shoqëria e sigurimeve të ky i fundit për llogari të kërkueseve. Ky kërkim i autoritetit kontraktor rezulton se nuk është përmbushur nga shoqëria e sigurimeve, duke u bërë objekt i një mosmarrëveshjeje tjetër gjyqësore mes autoritetit kontraktor dhe shoqërisë së sigurimeve në gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me nr. akti 2840, datë 8.3.2023.

5. Kërkueset, duke u vënë në dijeni të faktit që nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar transferimi i sigurimit të kontratës nga shoqëria e sigurimeve, në datën 30.12.2022 ato i janë drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me objekt detyrimin e palës së paditur për vijimin e procedurave të kontratës së koncesionit/PPP, duke thirrur në gjykim si palë të paditur autoritetin kontraktor dhe person të tretë të interesuar shoqërinë e sigurimeve. Në padi kërkueset kanë pretenduar se pala e paditur nuk ka përmbushur kushtet paraprake të kontratës, duke e bërë të vështirë vazhdimin e zbatimit të saj nga ana e koncesionarit.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. 1702 (980-2023-1754), datë 13.9.2023, ka vendosur: “Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor”. Kjo gjykatë, bazuar në nenin 9 të ligjit nr. 49, datë 30.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012), si dhe nenet 36 dhe 37 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), ka arritur në përfundimin se në nenin 54 të kontratës mes palëve është dakordësuar klauzola e arbitrazhit për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, arsye për të cilën ka përjashtuar juridiksionin gjyqësor për zgjidhjen e çështjes.

7. Me ankimin e veçantë të datës 25.9.2023 kërkueset i janë drejtuar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë i ka mohuar të drejtën për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur dhe ka interpretuar gabim ligjin dhe kontratën, duke e nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor.

8. Me vendimin nr. 00-2023-4463, datë 2.11.2023, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1702 (980-2023-1754), datë 13.9.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke arsyetuar se interpretimi i bërë nga ajo gjykatë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor është i bazuar në ligjin material dhe atë procedural. Sipas Gjykatës së Lartë, pavarësisht përdorimit të fjalës “mund” në nenin 54, pika 3, të kontratës, ku përcaktohet, se: “Kur mosmarrëveshja nuk zgjidhet me negociatë sipas nenit 54.1 apo secila nga Palët mund ta dërgojë mosmarrëveshjen në Procesin e Arbitrazhit ...”, shkallëzimi i mekanizmave zgjidhës në tërësi në nenin 54, renditja e tyre kronologjike dhe semantika e dispozitave të kontratës, reflektojnë vullnetin e palëve kontraktore që zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura t’ia nënshtrojnë ekskluzivisht arbitrazhit ndërkombëtar.

9. Në datën 1.3.2024 kërkueset kanë paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 18.3.2024. Kolegji i Gjykatës në datën 26.4.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, në datën 15.5.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkueset**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:

10.1 . *Së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur*, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i kanë cenuar aksesin në gjykatë, duke mos pranuar për shqyrtim themelin e pretendimeve të tyre. Kontrata koncesionare në nenin 54 ka përcaktuar mekanizimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve,

ku pikat 1 dhe 2 përcaktojnë zgjidhjen me negociata, ndërkohë që pika 3, duke përdorur fjalën “mund”, ka përcaktuar mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me arbitrazh ndërkombëtar si një alternativë ndaj zgjidhjes gjyqësore, por që në asnjë rast nuk e përjashton këtë të fundit. Edhe urdhrat e ekzekutimit, sipas nenit 54, pika 3, nën-pika 5, të kontratës, nxirren nga gjykatat vendase. Gjithashtu, neni 54, pika 3, i referohet zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ndërkohë që në padinë e tyre kërkueset kanë kërkuar vijimin e procedurave të zbatimit të kontratës koncesionare. Konventa e New York-ut, e ratifikuar nga shteti shqiptar, në nenin 2 përcakton, ndër të tjera, se gjykatat vendase nuk e përcjellin në arbitrazh një çështje objekt shqyrtimi në rastet kur marrëveshja në fjalë është jooperative ose e pamundur për t’u zbatuar. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi i ka krijuar pritshmëri të ligjshme kërkueseve lidhur me juridiksionin, duke qenë se në procesverbalin e veprimeve përgatitore të datës 31.1.2023 është shprehur, se: “Konstaton se kjo çështje administrative bën pjesë në juridiksionin gjyqësor sipas nenit 9 të ligjit nr. 49/2012”, nuk i ka lejuar të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Kjo e metë nuk është korrigjuar as nga Gjykata e Lartë, pasi nuk ka marrë parasysh pretendimet e kërkueseve lidhur me kërkesën për cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive dhe parimit të kontradiktoritetit në gjykimin në shkallë të parë, duke i privuar nga mundësia për zgjidhjen e konfliktit brenda sistemit gjyqësor shqiptar.

10.2 . *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë duhet ta kishte gjykuar çështjen me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit nr. 49/2012. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, nga ana e tij, jo vetëm që nuk e ka konstatuar këtë të metë, por edhe vetë e ka gjykuar çështjen me 3 gjyqtarë, ndërkohë që sipas nenit të sipërcituar duhet ta kishte gjykuar çështjen me 5 gjyqtarë.

10.3 . *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, për shkak se në gjykimin në shkallë të parë kërkueseve nuk u janë krijuar mundësi të njëjta dhe të barabarta për t’u mbrojtur dhe dëgjuar lidhur me pretendimet e tyre. Gjykata i ka vendosur kërkueset në një pozitë të diferencuar në raport me palën tjetër, duke treguar mungesë paanshmërie.

10.4 . *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi në gjykimin në shkallë të parë, kërkueseve nuk iu është krijuar mundësia që të debatojnë lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor, duke shkelur në këtë mënyrë parimet themelore që lidhen me të drejtën e mbrojtjes së palëve.

11. ***Subjekti i interesuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

11.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës së aksesit* është i pabazuar, pasi sipas parashikimeve të kontratës, në asnjë rresht nuk parashikohet që zgjidhja e mosmarrëveshjeve bëhet nga gjykatat shqiptare. Kërkueseve nuk u është cenuar e drejta aksesit, pasi me vullnet të plotë kanë rënë dakord që zgjidhja e mosmarrëveshjeve të bëhej ekskluzivisht nga arbitrazhi ndërkombëtar. Gjykatat shqiptare, si rast përjashtimor, sipas kontratës, janë kompetente vetëm për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit. Kërkueset nuk e quajnë mosmarrëveshje çështjen objekt të shqyrtimit gjyqësor edhe pse padia është ngritur menjëherë pas zgjidhjes së kontratës, duke qenë të vetëdijshme që mosmarrëveshja sipas nenit 54, pika 3, të kontratës koncesionare zgjidhet nga arbitrazhi. Për këtë arsye, kërkueset në padi nuk kundërshtojnë zgjidhjen e kontratës, por kërkojnë vijimin e saj.

11.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t’u dëgjuar* është i pabazuar, pasi në seancën gjyqësore kërkueset i kanë dhënë shkurtimisht kundërshtimet e tyre lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, duke i paraqitur ato me shkrim. Vetëm më pas Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë u shpreh me vendim. Gjithashtu, referuar nenit 3, pika 4, të ligjit nr. 49/2012, gjykatat administrative i shqyrtojnë çështjet gojarisht ose mbi bazë të dokumenteve. Në rastin konkret, ajo gjykatë kishte krijuar bindjen e brendshme për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor.

11.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi ligji nr. 49/2012 nuk ka parashikime për përbërjen e trupit gjykues në rastet e nxjerrjes së çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, ndërkohë që neni 158/a i KPC-së ka parashikuar se gjyqtari gjatë veprimeve përgatitore mund të vendosë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor pa e përcaktuar përbërjen e trupit gjykues.

11.4. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme* është i pabazuar, pasi kërkuueseve nuk i është shkelur asnjë e drejtë për sa kohë të dyja gjykatat ia kanë dhënë gjitha mundësitë paditësit për t'u shprehur dhe për t'u mbrojtur.

11.5. Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve* dhe *kontradiktoritetit* është i pabazuar, pasi kërkesa e autoritetit kontraktor është dorëzuar në gjykatë pasi është njohur me padinë dhe aktet shkresore të depozituara nga pala paditëse në gjykim. Ajo kërkesë është bazuar në parashikimet kontraktuale, fakt ky që është konstatuar edhe nga gjykatat.

12. **Subjekti i interesuar, shoqëria “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a.**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuueseve

13. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se kërkuueset legjitimohen *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Një kriter tjetër paraprak që duhet të përmbushet për të vënë në lëvizje procesin kushtetues është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 12, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, Gjykata vëren se kërkuueset e kanë ngritur në dy drejtime: *së pari*, pretendojnë se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë duhej ta kishte gjykuar çështjen me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit nr. 49/2012 dhe, *së dyti*, se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, jo vetëm që nuk e ka konstatuar këtë të metë, por edhe vetë ai nuk duhej ta kishte gjykuar çështjen me 3 gjyqtarë, por me 5, sipas përcaktimeve të dispozitës së sipërpërmendur.

17. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata konstaton se pretendimi lidhur me përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nuk është ngritur nga kërkuueset në rekursin e veçantë të paraqitur në Gjykatën e Lartë, por është artikulluar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuueset nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive që kanë pasur në dispozicion, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim. Ndërsa pretendimi për përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë lidhet me gjykimin në atë gjykatë, ndaj kërkuueset nuk kanë mjete të tjera në dispozicion. Edhe për sa u takon pretendimeve të tjera, kërkuueset i kanë ngritur në formë dhe substancë në rekursin e veçantë ose ato kanë të bëjnë me procesin në Gjykatën e Lartë, prandaj Gjykata çmon se ato kanë shteruar mjetet ligjore në dispozicion në lidhje me to.

18. Gjykata vlerëson se kërkueset legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 2.11.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 1.3.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkueset kanë pretenduar cenimin e *së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, parimit të paanshmërisë dhe atë të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, si dhe *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* në lidhje me përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë.

20. Subjekti i interesuar, autoriteti kontraktor, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* është i pabazuar, pasi ligji nr. 49/2012 nuk ka parashikime për përbërjen e trupit gjykues në rastet e nxjerrjes së çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, ndërkohë që neni 158/a i KPC-së ka parashikuar se gjyqtari gjatë veprimeve përgatitore mund të vendosë nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor pa e përcaktuar përbërjen e trupit gjykues.

21. Gjykata ka theksuar se shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj”, në sensin material, karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 31, datë 1.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkueset e kanë bazuar kërkesën e tyre në nenin 12, pika 3, të ligjit nr. 49/2012, i cili, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 49/2021, “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, të ndryshuar”, aktualisht përcakton, se: “*Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjykon me 3 gjyqtarë të gjitha çështjet, me përjashtim të rekurseve të paraqitura kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit që kanë shqyrtuar padi ndaj aktit nënligjor normativ, si dhe gjykimeve në seancë gjyqësore për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, të cilat gjykohen me 5 gjyqtarë.*”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se në gjykimin administrativ, objekti i mosmarrëveshjes së çështjes është ai që përcakton përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë.

23. Bazuar në sa më lart, duke qenë se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk gjendej përpara shqyrtimit të një rekursi lidhur me një akt nënligjor normativ ose një gjykim lidhur me njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, Gjykata vlerëson se shqyrtimi i çështjes nga një trup gjykues të përbërë nga 3 anëtarë nuk bie ndesh me parashikimet ligjore të nenit 12, pika 3, të ligjit nr. 49/2012. Në këto kushte, pretendimi i kërkueseve për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

24. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkueseve, Gjykata vëren se ato kanë argumentuar se u është cenuar e drejta e aksesit substancial e lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit, nuk kanë marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve të tyre, si dhe nuk i kanë dhënë atyre mundësinë për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur. Po kështu, kërkueset kanë pretenduar se u është cenuar edhe parimi i paanshmërisë dhe ai i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, duke dhënë po të njëjtat argumente, se në gjykimin në shkallë të parë nuk iu është krijuar mundësia që të dëgjohen dhe debatojnë lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor. Bazuar në këto argumente, Gjykata do të shqyrtojë në vijim bazueshmërinë e tyre në themel në drejtim të *së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e *së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur*

25. Kërkueset kanë pretenduar cenimin e *së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur*, pasi gjykatat nuk kanë shqyrtuar themelin e pretendimeve. Kontrata koncesionare në nenin 54 të saj ka përcaktuar mekanizimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ku pikat 1 dhe 2 përcaktojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me negociata, ndërkohë që pika 3, duke

përdorur fjalën “mund” ka përcaktuar mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me arbitrazh ndërkombëtar si një alternativë ndaj zgjidhjes gjyqësore, por që në asnjë rast nuk e përjashton këtë të fundit. Sipas tyre, neni 54, pika 3, i referohet zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, ndërkohë që në padinë e tyre kërkuaset kanë kërkuar vijimin e procedurave të zbatimit të kontratës koncesionare. Gjithashtu, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë nuk i ka dhënë mundësinë për t’u dëgjuar dhe mbrojtur lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Kjo e metë nuk është korrigjuar as nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

26. Subjekti i interesuar, autoriteti kontraktor, ka prapësuar se pretendimi i kërkueseve është i pabazuar, pasi sipas parashikimeve të kontratës, në asnjë rresht nuk parashikohet që zgjidhja e mosmarrëveshjeve bëhet nga gjykatat shqiptare. Kërkueseve nuk iu është cenuar e drejta aksesit, pasi me vullnet të plotë kanë rënë dakord që zgjidhja e mosmarrëveshjeve të bëhej ekskluzivisht nga arbitrazhi ndërkombëtar. Gjykatat shqiptare, si rast përjashtimor, sipas kontratës, janë kompetente vetëm për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit. Kërkuaset nuk e quajnë mosmarrëveshje çështjen objekt shqyrtimi gjyqësor edhe pse padia është ngritur menjëherë pas zgjidhjes së kontratës, duke qenë të vetëdijshme që mosmarrëveshja sipas nenit 54, pika 3, të kontratës koncesionare zgjidhej nga arbitrazhi. Për këtë arsye, kërkuaset në padi nuk kundërshtojnë zgjidhjen e kontratës, por vijimin e saj. Gjithashtu, në seancën gjyqësore kërkuaset i kanë dhënë shkurtimisht kundërshtimet e tyre lidhur me nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, duke i paraqitur ato me shkrim dhe më pas Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është shprehur me vendim.

27. Në kuptim të nenit 42, pika 1, të Kushtetutës, e drejta e aksesit i garanton individit të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tij dhe do të shpallë një vendim që u jep përgjigje atyre (pretendimeve) pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata i ka kushtuar rëndësi të veçantë rasteve kur gjykatat e zakonshme nxjerrin çështjet jashtë juridiksionit gjyqësor, për shkak se ky lloj vendimi gjyqësor ndërhyr tek e drejta e aksesit në gjykatë të individit. Sipas Gjykatës, e drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë thjesht formale, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 18, datë 15.3.2016; nr. 2, datë 29.1.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Edhe sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), zgjedhja vullnetare nga palët e juridiksionit të arbitrazhit, në parim, nuk ngre ndonjë çështje sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së (*shih Mutu dhe Pechstein kundër Zvicrës, datë 2.10.2018, § 96; Apollo Engineering Limited kundër Mbretërisë së Bashkuar (dek.), datë 2.7.2019, § 38*). Pranimi i një klauzole arbitrazhi që të konsiderohet si heqje dorë nga garancitë e procesit të rregullt ligjor duhet të jetë “i lirë, i ligjshëm dhe i paekuivok” (*shih Suda kundër Republikës Çeke, datë 28.10.2010, §48; Mutu dhe Pechstein kundër Zvicrës, datë 2.10.2018, § 96; Beg S.p.a kundër Italisë, datë 20.5.2021, § 127*). Po kështu, GJEDNJ-ja, në rastet e nxjerrjes së çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, ka pohuar se kufizohet ushtrimi i së drejtës së aksesit në gjykatë, ndaj duhet analizuar nëse rrethanat e rastit e justifikojnë një kufizim të tillë (*shih Cudak kundër Lituanisë, datë 23.3.2010, § 59*).

29. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar se drejta për t’u dëgjuar është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor. Kjo e drejtë, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t’u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 7, datë 12.3.2010; nr. 12, datë 606.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt ligjor, nuk nënkupton vetëm atë për t’u dëgjuar personalisht përpara gjykatës, pasi ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra nëpërmjet komenteve dhe shpjegimeve të dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Po kështu, Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme, pra të tilla që e bëjnë gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 4, datë 31.1.2024; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Nisur nga standardet e lartpërmendura dhe bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkueseve, në rastin në shqyrtim, Gjykata do të analizojë nëse atyre iu është dhënë mundësia të dëgjohen dhe të paraqesin parashtrimet e tyre në lidhje me çështjen e juridiksionit gjyqësor të ngritur gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar dhe nëse interpretimi i ligjit në këtë drejtim nga gjykatat e zakonshme ka rezultuar ose jo haptazi i paarsyeshëm.

32. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se gjykimi në shkallë të parë është vënë në lëvizje nga kërkuestet nëpërmjet kërkesëpadisë me objekt detyrimin e palës së paditur për vijimin e procedurave të kontratës së koncesionit/PPP. Gjatë këtij gjykimi, në seancën e parë gjyqësore, atë të veprimeve përgatitore, të datës 31.1.2023, autoriteti kontraktor, në cilësinë e palës së paditur, ka kërkuar nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Kërkuestet kanë kërkuar kohë që të njihen me këtë kërkesë dhe seanca është shtyrë për këtë qëllim. Gjithashtu, rezulton se nga ana e palëve në proces është kërkuar shtyrja e dy seancave pasardhëse, për arsye të ndryshme. Edhe seanca e radhës, e caktuar për në datën 8.6.2023, ka dështuar të zhvillohet, pasi ka rezultuar se kërkuestet nuk kishin marrë dijeni sipas ligjit. Prandaj seanca përgatitore rezulton se është zhvilluar në datën 13.9.2023 me praninë e kërkueseve dhe të autoritetit kontraktor.

33. Nga procesverbali i seancës së datës 13.9.2023, rezulton se pasi është verifikuar prezenca e palëve, si dhe fakti se nga ana e autoritetit kontraktor është paraqitur kërkesë për nxjerrjen jashtë juridiksionit të çështjes objekt gjykimi, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur të nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor. Nga përmbajtja e procesverbalit të seancës nuk rezulton që kërkuestet t'i kenë dhënë prapësimet e tyre me gojë ose me shkrim në seancë, ose t'i kenë kërkuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë që të administrojë pretendimet e tyre me shkrim. Për këtë arsye, në funksion të gjykimit kushtetues, Gjykata ka kërkuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë që të vihej në dispozicion regjistrimi audio i seancës së datës 13.9.2023. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka bërë me dije se ajo seancë nuk ishte regjistruar, pasi zhvillimi i saj është bërë në zyrën e gjyqtarit. Në këto kushte, nga aktet e dosjes gjyqësore nuk mund të provohej nëse kërkuestet kanë paraqitur prapësimet e tyre në lidhje me çështjen e juridiksionit gjatë gjykimit në shkallë të parë.

34. Gjithsesi, Gjykata vëren se nga data kur autoriteti kontraktor ka paraqitur kërkesën për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor (31.1.2023), deri në momentin që ajo është marrë në shqyrtim (13.9.2023), kërkuestet kanë pasur më shumë se 8 muaj, pra një periudhë të mjaftueshme në dispozicion për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes. Kjo do të thotë se edhe për shkak të rëndësisë që kishte çështja ato kishin mundësinë të paraqisnin prapësime me shkrim për të kundërshtuar kërkimet e autoritetit kontraktor, qoftë edhe duke i depozituar ato paraprakisht në sekretarinë e asaj gjykate.

35. Po kështu, Gjykata konstaton se kërkuestet, duke ushtruar ankim të veçantë ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kanë pasur mundësinë dhe kanë parashtruar në Gjykatën e Lartë pretendimet e tyre për çështjen e juridiksionit. Gjykata e Lartë, nga ana e saj, ka analizuar pretendimet e kërkueseve, duke pohuar se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka interpretuar drejt nenin 9 të ligjit nr. 49/2012, duke e nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor. Sipas Gjykatës së Lartë, juridiksioni lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve kontraktuale, në rastin konkret, i takon arbitrazhit të Parisit, sipas vullnetit të këtyre të fundit, të materializuar në kontratën e koncesionit. Ajo ka arsyetuar se pavarësisht përdorimit të fjalës “mund”

në nenin 54, pika 3, të kontratës, në tërësi, shkallëzimi i mekanizmave zgjidhës (negociatat dhe eksperti teknik), renditja e tyre kronologjike dhe semantika e dispozitave në pikat 2 dhe 3 të nenit 54 të kontratës, reflektojnë vullnetin e palëve kontraktore që zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura t'ia nënshtrojnë ekskluzivisht arbitrazhit ndërkombëtar, duke përjashtuar në mënyrë implicite juridiksionin gjyqësor shqiptar (*shih paragrafin 20 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

36. Për pretendimet e kërkuueseve, për cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive ose parimit të kontradiktoritetit, Gjykata e Lartë ka argumentuar se këto pretendime i vlerëson të pabazuara dhe jo relevante, duke qenë se nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit mund të ngrihet edhe kryesisht nga gjykata, në çdo gjendje ose fazë të gjykimit, duke nënkuptuar të domosdoshme vetëm bindjen e gjykatës për mungesën e pushtetit juridiksional për të gjykuar një mosmarrëveshje (*shih paragrafin 21 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

37. Nga sa më lart, Gjykata, në ndryshim nga Gjykata e Lartë, i vlerëson në parim si të rëndësishme pretendimet e kërkuueseve për respektimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit, megjithatë çmon se në kontekstin e rrethanave të rastit në shqyrtim ato edhe pse kanë pasur në dispozicion një hark kohor prej 8 muajsh, kanë zgjedhur të mos paraqesin prapësime me shkrim në lidhje me çështjen e juridiksionit gjyqësor, ndërsa në vijim kanë paraqitur argumentet e tyre në ankimin e veçantë. Kjo do të thotë se ato kanë paraqitur mendimin e tyre për këtë çështje më së paku në ankimin e veçantë ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ky fakt, në vetvete, ka passjellë një mundësi të dytë për kërkuueset për t'u dëgjuar, si dhe korrigjimin e çdo të metë që mund të ketë rezultuar nga gjykimi në gjykatën e shkallës së parë për këtë pretendim.

38. Gjithashtu, Gjykata çmon se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar kontratën objekt mosmarrëveshjeje dhe e ka interpretuar atë brenda kompetencave të saj në raport me parashikimet ligjore që rregullojnë juridiksionin gjyqësor dhe atë të arbitrazhit, duke dalë në përfundimin se palët më vullnetin e tyre ia kanë nënshtuar ekskluzivisht arbitrazhit ndërkombëtar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura. Në këtë kuptim, në interpretim të dispozitave ligjore dhe kontraktuale që gjejnë zbatim në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka dhënë një vendim të arsyetuar për nxjerrjen e çështjes administrative jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar, pra të tillë që justifikon mosshqyrtimin e themelit të mosmarrëveshjes. Prandaj, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që interpretimi i ligjit për këtë çështje nga Gjykata e Lartë të ketë qenë arbitrar në nivelin që të mund të konsiderohet se kërkuueseve u janë cenuar të drejtat kushtetuese të pretenduara.

39. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuueseve në drejtim të cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, nuk janë të bazuara, prandaj kërkesa duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 17.10.2024.

Shpallur më 12.11.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Fiona Papajorgji, Marjana Semini

Anëtarë kundër: Sonila Bejtja, Sandër Beci

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që u përket kërkuueseve, shoqërive “ANK” sh.p.k. dhe “Bardh Konstruktion” sh.p.k., me objekt: “*Shfuqizimi i vendimeve nr. 1702, datë 13.9.2023, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë; nr. 00-2023-4463, datë 2.11.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, jemi kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi, në vlerësimin tonë, pretendimi i kërkuueseve është i bazuar, për arsyet që do të parashtrohen në vijim.

2. Shumica e ka analizuar çështjen konkrete në këndvështrim të së drejtës së aksesit në gjykatë, si element i së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, e lidhur kjo edhe me të drejtën për t’u dëgjuar edhe për t’u mbrojtur. Në përfundim, shumica e ka gjetur këtë pretendim të pabazuar, duke vlerësuar se, në kontekstin e rrethanave të rastit në shqyrtim, kërkuueset, edhe pse kanë pasur në dispozicion një hark kohor prej 8 muajsh, kanë zgjedhur të mos paraqesin prapësime me shkrim në lidhje me çështjen e juridiksionit gjyqësor, ndërsa në vijim kanë paraqitur argumentet e tyre në ankimin e veçantë. Kjo tregon se ato kanë paraqitur mendimin e tyre për këtë çështje më së paku në ankimin e veçantë ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ky fakt, sipas shumicës, në vetvete, ka passjellë një mundësi të dytë për kërkuueset për t’u dëgjuar, si dhe korrigjimin e çdo të mete që mund të ketë rezultuar nga gjykimi në shkallë të parë në lidhje me këtë pretendim (*shih paragrafin 37 të vendimit*).

3. Po kështu, shumica ka vlerësuar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar kontratën objekt mosmarrëveshjeje dhe e ka interpretuar atë brenda kompetencave të saj në raport me parashikimet ligjore që rregullojnë juridiksionin gjyqësor dhe atë të arbitrazhit, duke dalë në përfundimin se palët më vullnetin e tyre ia kanë nënshtruar ekskluzivisht arbitrazhit ndërkombëtar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura. Në këtë kuptim, në interpretim të dispozitave ligjore dhe kontraktuale që gjejnë zbatim në rastin konkret, Gjykata e Lartë ka dhënë një vendim të arsyetuar për nxjerrjen e çështjes administrative jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar, pra të tillë që justifikon mosshqyrtimin e themelit të mosmarrëveshjes (*shih paragrafin 38 të vendimit*).

4. Referuar rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim dhe pa dashur të cenojmë themelin e çështjes që ka të bëjë me juridiksionin e zbatueshëm për zgjidhjen e kontratës, vërejmë se midis autoritetit kontraktor dhe kërkuueseve ka pasur mosmarrëveshje lidhur me zbatimin e kontratës koncesionare, duke bërë që autoriteti kontraktor të niste procedurat e ndërprerjes së kontratës. Për këtë shkak, nga ana e kërkuueseve është vënë në lëvizje procesi gjyqësor, duke kërkuar vijimin e kontratës së koncesionit me autoritetin kontraktor, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot-Balldre. Nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është bërë nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor për t’u shqyrtuar nga arbitrazhi ndërkombëtar. Për rekursin e kërkuueseve, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit gjykatës së shkallës së parë.

5. Kërkuueset kanë pretenduar përpara Gjykatës se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, i lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë, u ka cenuar atyre të drejtën e aksesit në gjykatë të lidhur edhe me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur. Sipas tyre, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në seancën e datës 13.9.2023, nuk iu ka dhënë atyre mundësinë për t’u dëgjuar dhe mbrojtur lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Kjo e metë nuk është korrigjuar as nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjatë marrjes në shqyrtim të rekursit të tyre.

6. Referuar thelbit të pretendimeve të kërkuueseve, që ka të bëjë me dëgjimin e tyre për këtë konkluzion, në vlerësimin tonë, ky pretendim duhej të ishte trajtuar si në këndvështrim të së drejtës së mbrojtjes në gjykim, në aspektin e garantimit të së drejtës së kërkuueseve, si palë në gjykim, për t’u dëgjuar nga gjykata në lidhje me pretendimin e tyre për shqyrtimin e çështjes nga juridiksioni gjyqësor shqiptar, ashtu edhe në drejtim të parimit të barazisë së palëve në gjykim. Gjithashtu, në këndvështrim të parimit të barazisë së palëve në procesin gjyqësor nga Gjykata e Lartë është marrë në konsideratë prapësimi i autoritetit kontraktor dhe jo pretendimi i tyre për këtë argument.

7. Në lidhje me të drejtën e mbrojtjes, Gjykata ka vlerësuar se ajo është një element thelbësor i një procesi të rregullt. Që kjo e drejtë të jetë reale dhe efektive, dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimin nr. 73, datë 14.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e mbrojtjes dhe ajo për t'u dëgjuar, në unitet edhe me të drejta të tjera, kanë për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 7, datë 12.3.2010; nr. 12, datë 6.6.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Shumica ka konkluduar se nuk arrihet të dokumentohet nëse, kërkueseve iu është mohuar kjo e drejtë ose jo, për arsye të moszhvillimit të seancës gjyqësore (të datës 13.9.2023) me sistemin e regjistrimit audio në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ajo gjykatë, pas kërkesës së autoritetit kontraktor, ka interpretuar nenin 54, pika 3, të kontratës, duke e nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor, referuar edhe nenit 9 të ligjit nr. 49/2012. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nga ana e tij, lidhur me këtë pretendim të kërkueseve, arsyeton se lidhur me pretendimet e palës paditëse për cenimin e parimit të mbrojtjes efektive ose parimit të kontradiktoritetit, i vlerëson ato të pabazuara dhe jo relevante, për sa kohë që nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor mund të ngrihet edhe kryesisht nga gjykata në çdo gjendje ose fazë të gjykimit (*shih paragrafin 21 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Gjithashtu, Gjykata e Lartë në arsyetimin e saj është ndalur kryesisht në analizimin dhe interpretimin e nenit 54 të kontratës së koncesionit lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe arsyet e përjashtimit të juridiksionit shqiptar.

9. Në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, kërkueset, në thelb, kanë pretenduar se nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë atyre iu është cenuar, ndër të tjera, edhe parimi i kontradiktoritetit edhe e drejta për t'u dëgjuar, si dhe për t'u mbrojtur. Megjithatë, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se ky pretendim është irrelevant.

10. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Kur janë të pranishme pretendime me natyrë kushtetuese, respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 16, datë 16.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Po kështu, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime, të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 13, datë 9.3.2021; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Edhe pse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, rezulton se kërkueset nuk janë dëgjuar nga gjykata e shkallës së parë në lidhje me pretendimin për shqyrtimin e kërkesës së tyre nga juridiksioni gjyqësor shqiptar, i cili ka rëndësi thelbësore për çështjen, pasi lidhet, në thelb, me të drejtën për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar, Gjykata e Lartë, pavarësisht funksionit të saj si gjykatë ligji dhe rolit të saj të pazëvendësueshëm të kontrollit dhe të respektimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor duhej ta merrte në shqyrtim atë dhe t'i jepte përgjigje të arsyetuar e përfundimtare, për sa kohë pretendimi i kërkueseve është me natyrë kushtetuese. Gjykata e Lartë e ka konsideruar irrelevant këtë pretendim dhe nuk e ka marrë në shqyrtim atë edhe pse ai në thelb lidhet me (pa)mundësinë e kërkueseve për zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes së tyre nga gjykatat shqiptare dhe ushtrimin e të drejtave të tyre.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka interpretuar përcaktimet e kontratës lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke vlerësuar se juridiksioni lidhur me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve kontraktuale, në rastin konkret, i takon arbitrazhit të Parisit, sipas vullnetit të këtyre të fundit, të materializuar në kontratën e koncesionit. Ajo ka arsyetuar se pavarësisht përdorimit të fjalës “*mund*” në nenin 54, pika 3, të kontratës, në tërësi, shkallëzimi i mekanizmave zgjidhës (negociatat dhe ekspertit teknik), renditja e tyre kronologjike dhe semantika e dispozitave në pikat 2 dhe 3 të nenit 54 të kontratës, reflektojnë vullnetin e palëve kontraktore që zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura t’ia nënshtrojnë ekskluzivisht arbitrazhit ndërkombëtar, duke përjashtuar në mënyrë implicite juridiksionin gjyqësor shqiptar.

14. Megjithatë, në ndryshim nga shumica, në vlerësimin tonë, interpretimi i Gjykatës së Lartë, edhe pse brenda funksionit të saj si gjykatë ligji, nuk është i mjaftueshëm për të konsideruar të përmbushur detyrimin e respektimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa kohë që ajo gjykatë, në kushtet që gjykata e shkallës së parë nuk i ka dhënë mundësinë kërkueseve të paraqisnin pretendimet e tyre dhe të dëgjohen, duhet t’ia kishte garantuar këtë të drejtë dhe të merrte në shqyrtim pretendimin për shqyrtimin e çështjes nga juridiksioni gjyqësor. Kjo merr rëndësi edhe për faktin se kërkueset kanë pretenduar se neni 54, pika 3, i kontratës koncesionare i referohet zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes palëve, ndërkohë që në objektin e padisë së tyre ato kanë kërkuar vijimin e procedurave të zbatimit të kontratës koncesionare, duke mos e trajtuar çështjen vetëm si një mosmarrëveshje, por si një ndërprerje të njëanshme të kontratës nga autoriteti kontraktor, në kundërshtim me ligjin.

15. Mënyra se si ka vepruar Gjykata e Lartë, në vlerësimin tonë, i ka vënë kërkueset në pamundësi të ushtrojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes ndaj vendimit të dhënë nga vetë ajo dhe në këtë mënyrë procesi gjyqësor i zhvilluar në atë gjykatë nuk ka garantuar respektimin e së drejtës për t’u mbrojtur.

16. Në përfundim të argumenteve të mësipërme, në vlerësimin tonë, Gjykata e Lartë, duke mos i dëgjuar kërkueset për sa ato pretendonin për këtë element të parashikimit kontraktor, u ka mohuar atyre të drejtën për t’u mbrojtur dhe për t’u dëgjuar, për rrjedhojë çmojmë se ankimi kushtetues individual i tyre duhej të pranohej pjesërisht vetëm në drejtim të pretendimit të mësipërm dhe të vendosej shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, duke e kthyer çështjen për rigjykim pranë asaj gjykate në zbatim të parimit të subsidiaritetit.

Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja